

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrëfhehet Kylian Mbappe: Ky është viti, Topi i Artë duhet të kthehet në Bernabeu! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/rrrefehet-kylian-mbappe-ky-eshte-viti-topi-i-arte-duhet-t-e-kthehet-ne-bernabeu/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:32:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:31:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ae03a04043f5dc5de4e93be41c13902e12e39efb082cb698e89cf42f9737348
TEKSTI	d87c607f816a74551d989aaffd77f327c359c2306d5ae619c19e66481dff0cdc
PAMJA	3b6bf7c6bfc3a396561110ee7b62377fb954485aafb348ed18ccc2fdd6d260fd8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d5d6d039658ec6c3a28e0c777960b02e1d286eebf21dfa61e4a82c14834aee9f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d5d6d039658ec6c3a28e0c777960b02e1d286eebf21dfa61e4a82c14834aee9f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Sport

Rrëfëhet Kylian Mbappe: Ky është viti, Topi i Artë duhet të kthehet në Bernabeu!



Ervin Nikolla

17 Shtator 2026



K ylian Mbappe **ka folur për objektivat** e tij me Real Madridin, rivalitetin për Topin e Artë dhe çështjen e fanellave të Ceutës.

Në një intervistë të dhënë për AS, sulmuesi francez, i cili ka nisur sezonin e tretë me fanellën e Real Madridit, e sheh këtë vit si një mundësi të mirë për të fituar trofeun individual më prestigjioz.

“Mendimi im është se ky është një vit i mirë për ta fituar atë. Avokati im më i mirë janë këmbët e mia. Pavarësisht se sa flas, gjëja më e rëndësishme për mua është që Topi i Artë të kthehet te Real Madridi. Duhet të kthehet në Bernabeu, te tifozët e Madridit, për t’u sjellë gëzim të gjithë këtyre njerëzve. Ata e meritojnë më shumë se kushdo tjetër”, u shpreh Mbappé.

Një nga rivalët kryesorë të Mbappé për Topin e Artë është edhe talenti i Barcelonës, **Lamine Yamal**. Francezi pati fjalë vlerësuese për 19-vjeçarin.

“Mendoj se ai është një lojtar shumë i talentuar dhe kam një ndjenjë se do të ketë një karrierë të shkëlqyer. I uroj gjithë të mirat”, tha Mbappé.

Intervista e plotë me sulmuesin e Real Madridit pritet të publikohet në kuadër të një programi special të AS. Në të, Mbappé flet edhe për Florentino Pérez, José Mourinho, transferimin e tij te Real Madridi, marrëdhënien me Vinicius Junior dhe Jude Bellingham, si dhe për derbin.

Mbappe t'oi gjithashtu per polemikat qe u krijuan pas ndeshjes se Real Madridit ndaj Eiches, kur ai, Vinicius dhe Konatë nuk e veshën plotësisht fanellën në mbështetje të Ceutës.

Francezi sqaroi se vendimi për fanellat ishte marrë nga klubet, ndërsa lojtarët duhej t'i vishnin ato.

“Dua ta shpjegoj qartë që njerëzit ta kuptojnë. Ishte vendimi i klubeve të sillnin fanellën, ta vishnin atë. Ne lojtarët duhej ta vishnim. Gjëja e parë që dua të them është se kam solidaritet të plotë me Ceutën dhe të gjitha viktimat. Sepse përpara se të jem lojtar, jam njeri”, deklaroi ai.

Mbappé shtoi se dëshironte gjithashtu të shprehte mbështetjen për emigrantët që kanë humbur jetën ose që jetojnë në kushte të vështira.

“Nuk ishte një pozicion i lehtë, ishte i vështirë, sepse në fund njerëzit mund të mendojnë se jam kundër popullit të Ceutës, por jo, absolutisht jo. Nuk kam asgjë kundër tyre dhe i mbështes 100% në mendimet e mia”, tha ai.

Sulmuesi francez theksoi se synimi i tij ishte të mos vendoste vuajtjet e një grupi njerëzish mbi ato të një grupi tjetër.

“Jam njeri dhe nuk dua t'i jap përparësi vuajtjeve të disave mbi ato të tjerëve. Ka njerëz që vuajnë dhe më trishton shumë ta shoh këtë në botë. Unë jam një njeri që dua më të mirën për botën në të cilën jetojmë. Kam ndërmend të dërgoj një mesazh pozitiviteti dhe paqeje dhe shpresoj që kjo të zgjidhet shpejt”, përfundoi Mbappé.

LAJME TË NGJASHME



Milan, vërshtëllimat e tifozëve dhe zhgënjimi i Cardinale-s, Amorim përfundon i akuzuar!

2.5 MIN



FIFA trondit klubet shqiptare! Ja vendimi drastik!

1.5 MIN



Zvicra, trajneri Yakin: Xhaka po luan mirë, do na duhet

1 MIN



Barcelona mendon për epokën pas Hansi Flick, Cesc Fabregas në krye të listës

1.5 MIN



Messi shënoi gol për trofeun e 49-të në karrierë!

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Majko përlohet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi glykues: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim

EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë..." / Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egove të kolegeve të mia..." / Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...



Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin...



10 pjesët më të mira të mishit të viçit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!



Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo

LINKS

Kontaktimi Marketing

informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.	Email: Tel: +355 69 208 0500 +355 69 442 8873	riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.	Frekuencat Aksesueshmëria Mundësi Punësimi Privacy Policy & Terms
--	--	---	---

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.